



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

DSIK
DEKLASIFIKUAR PJESËRISHT
ME VENDIM TË KDZH
Nr. 2283/2021
Tirane, më 6/12/2021

Nr. 12535/Prot

"Sekret"
Afati i klasifikimit 10 vjet
Kopje, nr. 1
Tiranë, më 2/11/201

Lënda: Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Zj.Mimoza Eqerem Brahimi.

Drejtuar: KOMISIONIT TË PAVARUR TË KU ALIFIKIMIT

TIRANË

Në zbatim të kërkesave të nenit 39, pika 2, të Ligjit nr. 84/2016 "Për Rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Zj.Mimoza Eqerem Brahimi, me detyrë gjyqtar, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ju informon se:

1. Referuar Deklaratës për Kontrollin e Figurës së Subjektit të Rivlerësimit, Grupi i Punës shqyrtoi me kujdes dosjen e Zj.Mimoza Eqerem Brahimi, nga ku rezulton se:

Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 84/2016. Pas diskutimeve të anëtarëve të Grupit të Punës u vendos dërgimi i kërkesës për verifikimin e kontrollit të figurës në Prokurorinë e Përgjithshme, SHISH dhe SHÇBA

2. Informacionet e ardhura nga institucionet e verifikimit.

[REDACTED]

me dije se:

na bëjne

- a. Subjekti i rivlerësimit Zj.Mimoza Eqerem Brahimi ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si të deklaruar apo paraqitura nga etë ajo në Deklaratën për Kontrollin e Figurës
- b. Për subjektin e rivlerësimit Zj.Mimoza Eqerem Brahimi administrohen informaci ne konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të përfshirjes në kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e rganizuar, k nketisht

SEKRET

Faqe 1 nga 1

Pas verifikimeve të kryera nga autoritetet verifikuese jemi vënë në dijeni të fakteve se:
"Disponohen të dhëna të vitit 2009 nga të cilat rezulton se shtetasi Fatos Fatmir Brahimi (djali i subjektit), është arrestuar për veprat penale "Plagosje e rëndë me dashje" dhe "Armëmbajtje pa leje".

Gjithashtu, me vendimin nr. 1290, datë 20.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është dënuar me 8 muaj burgim për veprat penale "Plagosje e rëndë me dashje, në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake".

Fatos Fatmir Brahimi (djali i subjektit) është dënuar me 3 vjet burg nga autoritetet Italiane për veprën penale "Trafik i narkotikëve".

Në vlerësim të të dhënave që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit gjykojmë se:

1. Informacionet që disponohen në ngarkim të Zj. Mimoza Eqerem Brahimi për veprimtari të përfshirë në krimin e organizuar, evidentojnë rrethanat e konstatimit të faktit se ekziston kontakt i papërshtatshëm me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimit të pikës 13, të nenit 3, të ligjit 84/2016, në formën e "personit të lidhur", fëmijë madhorë, që ka marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit.
2. Referuar informacioneve të marra nga institucionet verifikuese, subjekti i rivlerësimit Zj. Mimoza Eqerem Brahimi rezulton individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga struktura kriminale, sipas përcaktimit të germës c, të nenit 37 të ligjit 84/2016.
3. Nga autoritetet verifikuese ekzistojnë të dhëna se subjekti Zj. Mimoza Eqerem Brahimi ka lidhje të ngushta me person të përfshirë në krimin e organizuar, rrethanë kjo që merret parasysh në konstatimin e faktit se ekzistojnë kontakte të papërshtatshme, sipas përcaktimeve të pikës 4, germa ç, të nenit 38, të ligjit 84/2016.
4. Theksojmë gjithashtu se, jemi para një rrethane që merret parasysh në konstatimin se formulari i deklaratimit nuk është plotë dhe i besueshëm sipas përcaktimit të bërë në pikën 6, germa a, neni 38, i ligjit 84/2016, ku subjekti i rivlerësimit Zj. Mimoza Eqerem Brahimi nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme.
5. Bazuar në nenin 38, të ligjit 84/2016, ligjvënësi i është referuar kontakteve të papërshtatshme që mund të ketë subjekti i rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Nisur nga qëllimi dhe fryma e ligjit, ku procesi i rivlerësimit përfshin kontrollin tërësor të prokurorëve dhe gjyqtarëve duke filluar nga vetë subjekti e më pas duke zbuluar ose identifikuar lidhjet e subjekteve me krimin e

organizuar, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit është subjekt i kontrollit të ligjit dhe i përfshirjes ose jo në krimin e organizuar.

6. Mbështetur në informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese, merret në konsideratë fakti se janë marrë nga burime të besueshme.



8. Sa sipër, Grupi i Punës konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Zj. Mimoza Eqerem Brahimi .

Bashkëlidhur ju dërgojmë Deklaratën për Kontrollin e Figurës dhe shkresën e SHÇBA Nr. 1357 3 Prot. datë 20.9.2017.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

DREJTORI

Dorian TOLA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Dorian Tola'.